# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6109
E mërkurë, 9 shtator 2020
çmimi 0.40 €


## LV-ja: Marrëveshja e Uashingtonit shkel Kushtetutën
FAQE 5





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI FAQE 4-5

# KRITIKAT E OPOZITËS PËR MARRËVESHJEN E UASHINGTONIT JANË TË DREJTA, POR NUK JANË REALE

Politologu Ramush Tahiri e ka vlerësuar historike marrëveshjen në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se marrëveshja e nënshkruar më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë e ka fuqizuar ndërkombëtarisht Republikën e Kosovës. Tahiri ka thënë se ky dokument i trajton plotësisht të barabartë Kosovën dhe Serbinë. Sipas tij, në këtë marrëveshje Serbia asgjë nuk ka më shumë se Kosova. Duke folur për kritikat e opozitës në raport me këtë marrëveshje, Tahiri ka theksuar se kritikat e opozitës janë të drejta, por nuk janë reale pasi, sipas tij, edhe kjo opozitë po të ishte në pushtet nuk do të mund të bënte më shumë



## Asnjë viktimë nga Covidi gjatë 24 orëve në Kosovë




Autoritetet shëndetësore në Kosovë nuk kanë regjistruar asnjë viktimë nga Covid-19 në 24 orët e fundit. Nga testimi i 1481 mostrave, 97 pacientë kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka njoftuar se brenda 24 orëve janë shëruar edhe 139 pacientë. Me këto shifra, numri i përgjithshëm i të prekurve me Covid në Kosovë arrin në 14 301 FAQE 7

## Kosova kërkon nga BE-ja përmbylljen sa më të shpejtë të procesit të liberalizimit të vizave
FAQE 2



## OPINION

### LUFTË ABSURDE PËR KARRIGEN E ZËNË TË PRESIDENTIT F. 11

Milazim KRASNIQI



## AKTUALE



### FILLON TESTIMI I MËSIMDHËNËSVE PËR COVID-19 F. 2

### TESTI I MATURËS, AFATI I DYTË, DO TË MBAHET MË 10 TETOR F. 6

## EKONOMI



### ATK-JA DHE DOGANA VAZHDOJNË BASHKËPUNIMIN PËR KOORDINIMIN E AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA F. 8

## KULTURË

### EMËROHET KËSHILLI I RI I QKK-së F. 6

## SPORT

### IVAN FUSTAR PËRFORCON GJILANIN, SERMAXHAJ EMËROHET TRAJNER I PORTIERËVE F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net I www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Kosova kërkon nga BE-ja përmbylljen sa më të shpejtë të procesit të liberalizimit të vizave





**Bruksel, 8 shtator (ER)** - Gjatë vizitës zyrtare në Bruksel, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, është pritur në takim nga komisionari i Bashkimit Evropian për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi, me të cilin ka biseduar për zhvillimet e fundit politike në vend.
Kryeministri Hoti e ka njoftuar komisionarin Varhelyi për prioritetet e Qeverisë së Kosovës, në veçanti për menaxhimin e situatës së krijuar me Covid-19, për masat që janë ndërmarrë dhe për Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike.
Në emër të Qeverisë së Kosovës, kryeministri Hoti i ka falënderuar institucionet e BE-së për mbështetjen financiare dhe teknike që i kanë dhënë Kosovës për luftimin e pandemisë. Ai, po ashtu, ka shtruar nevojën e përmbylljes sa më të shpejtë të procesit të liberalizimit të vizave, duke theksuar se qytetarët e Kosovës meritojnë të lëvizin lirshëm sikurse popujt e tjerë, pasi janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara.
Kryeministri Hoti ka folur edhe për marrëveshjen e normalizimit të marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, të nënshkruar në Uashington më 4 shtator, e cila paraqet një akt të vullnetit të mirë për të ecur më tej drejt marrëveshjes gjithëpërfshirëse në mes të dy vendeve, e cila duhet të rezultojë me njohje reciproke.

## Stoltenberg: NATO-ja do të ofrojë edhe më tutje përkrahje për Kosovën

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka bërë me dije se NATO-ja do të ofrojë edhe më tej përkrahje të gjithanshme për Kosovën, për të siguruar një mjedis paqësor dhe një të ardhme të sigurt për të gjithë qytetarët e saj. Këtë deklaratë Stoltenbergu e dha gjatë pritjes që i bëri në Bruksel kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti.
Në këtë takim, në të cilin u bisedua për zhvillimet politike dhe ato të sigurisë në vendin tonë, kryeministri Hoti shprehu falënderimin e tij dhe të popullit të Kosovës për misionin e KFOR-it në Kosovë, duke theksuar se prania e NATO-s/KFOR-it, është e një rëndësie të veçantë për forcimin e paqes dhe të stabilitetit në këtë pjesë të Evropës Juglindore.
Hoti e ka falënderuar sekretarin Stoltenberg edhe për ndihmën që ua ka dhënë KFOR-i institucioneve të Republikës së Kosovës për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Duke e vlerësuar rolin e Aleancës Veriatlantike për paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar, kryeministri Hoti theksoi përkushtimin e Kosovës për ndërtimin e një të ardhmeje euroatlantike dhe synimin që Kosova sa më parë të bëhet anëtare e NATO-s.
Në fund të këtij takimi, kryeministri Hoti e ftoi sekretarin Stoltenberg ta vizitojë Kosovën sa më parë që t'i jepet rasti.

# Fillon testimi i mësimdhënësve për Covid-19

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 8 shtator** - Mbi 1 500 mësimdhënës në gjithë territorin e Kosovës do të testohen për koronavirus para se të fillojë procesi mësimor më 14 shtator ka njoftuar ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj. "Ne kemi marrë informata se do të testohen 1 500 arsimtarë në nivel të Kosovës, që i bie mbi 6.5 për qind e numrit të përgjithshëm të arsimtarëve, në mënyrë që ta dimë situatën e infeksionit me Covid-19 ose me cilën gjendje po hyjmë në vitin e ri shkollor. Testimi ka filluar. Edhe nga Komuna e Shtimes, arsimtarët e përzgjedhur në mënyrë të rastësishëm, kanë shkuar të testohen në qytetin e Ferizajt", ka thënë ministri Likaj gjatë vizitës që ua ka bërë të martën disa shkollave në Komunën e Shtimes.
Në këtë vizitë ministri Likaj ishte i shoqëruar edhe nga kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), Rrahman Jashari.
Ministri Likaj u shpreh i kënaqur me përgatitjet që kanë bërë DKA-ja dhe mësimdhënësit në Shtime, për përgatitjet rreth fillimit të vitit të ri shkollor, ndërkaq theksoi se edhe Qeveria dhe Ministria e Arsimit janë të përgatitur në këtë drejtim, në koordinim të plotë edhe me SBAShK-un. Ata kanë përsëritur vendimin se viti i ri shkollor 2020-2021 në kohë pandemie do të nisë më 14 shtator, duke respektuar rekomandimet e institucioneve shëndetësore për mbrojtje nga sëmundja Covid-19.
Kryetari i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, falënderoi ministrin Likaj për bashkëpunimin që është duke treguar gjatë gjithë kohës, ndërkaq u shpreh i bindur se ministria dhe shkollat kanë bërë të gjitha përgatitjet për ta filluar mësimin më 14 shtator. Ai ka thënë se SBAShK-u do të jetë gjithmonë afër ministrit Likaj dhe Ministrisë së Arsimit për çdo angazhim të tyre për të mirën e arsimit në Kosovë.
Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka marrë vendim që mësimi të fillohet në mënyrë fizike në objektet e shkollave, të hënën, më 14 shtator.
Viti i ri shkollor është dashur të fillojë më 1 shtator, por është shtyrë, siç është thënë nga Ministria e Arsimit, me qëllim



të sigurimit të kushteve të sigurta për fëmijët, mësimdhënësit dhe prindërit.
Në udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), për ruajtje të shëndetit të nxënësve në shkolla, thuhet se shkolla duhet të sigurojë që të respektohet distanca e caktuar e sigurisë të paktën 1.5 metra, secilit nxënës si dhe personelit të shkollës duhet t'i bëhet matja e temperaturës përmes termometrit laserik çdo ditë.
Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve në nivel vendi llogaritet të jetë mbi 23 mijë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Hoti kërkon të raportojë në Kuvend për marrëveshjen në Uashington

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka kërkuar t'i mundësohet që, në njërën nga seancat e ardhshme, të raportojë në Kuvendin e Kosovës për marrëveshjen e normalizimit të marrëdhënieve ekonomike në mes të Kosovës dhe Serbisë, të nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë. Ai ka thënë se më 4 shtator 2020, në Uashington, në Shtëpinë e Bardhë, është arritur një marrëveshje e rëndësishme për vendin tonë lidhur me normalizimin e marrëdhënieve ekonomike në mes të Kosovës dhe Serbisë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 8 shtator** - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se ka kërkuar që në njërën nga seancat e ardhshme të raportojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për marrëveshjen e normalizimit të marrëdhënieve ekonomike në mes të Kosovës dhe Serbisë, të nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë. Hoti ka thënë se më 4 shtator 2020, në Uashington, në Shtëpinë e Bardhë, është arritur një marrëveshje e rëndësishme për vendin tonë lidhur me normalizimin e marrëdhënieve ekonomike në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive të mia kushtetuese dhe ligjore, jam i gatshëm që në njërën nga seancat e radhës të Kuvendit të Republikës së Kosovës të raportoj para deputetëve për marrëveshjen në fjalë si dhe për procesin e dialogut në përgjithësi", ka deklaruar kryeministri Hoti.

Më 4 shtator në praninë e presidentit amerikan, Donald Trump, kryeministri Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, u pajtuan për normalizimin e raporteve ekonomike. Marrëveshja parasheh bashkëpunim ekonomik mes dy vendeve. Palët janë zotuar se do të zbatojnë një sërë marrëveshjesh të arritura tashmë, siç është ajo për autostradën në mes të Kosovës dhe Serbisë, ajo për hekurudhat dhe për linjën ajrore. Po ashtu, aty parashihet që Kosova dhe Serbia t'i përshpejtojnë përpjekjet për t'i lokalizuar dhe identifikuar mbetjet e personave të humbur.

Në bazë të marrëveshjes, Kosova dhe Serbia do t'i bashkohen "zonës së mini-Schengenit", që është krijuar më 2019 dhe ku tashmë marrin pjesë, Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Kosova, sipas marrëveshjes, po ashtu është pajtuar që brenda një viti të mos kërkojë anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Serbia, në anën tjetër, është pajtuar që brenda një viti ta ndalë fushatën për çnjohjen e pavarësisë së Kosovës.

Sa i përket Liqenit të Ujmanit, në marrëveshje thuhet se palët do të punojnë me Departamentin Amerikan të Energjisë për një studim fizibiliteti, me qëllim të përdorimit të përbashkët të këtij liqeni, si furnizues i sigurt i ujit dhe energjisë.

Një takim që ishte paraparë të mbahej në Uashington më 27 qershor u anulua pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar me seli në Hagë kishte deklaruar se ka paraqitur një aktakuzë për krime lufte ndaj presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i cili ishe i ftuar në këtë takim.

Ndërsa më 7 shtator, Hoti dhe Vuçiqi u takuan në Bruksel, ku biseduan për një varg çështjesh. Hoti tha se është shënuar përparim në draftimin e marrëveshjes finale, ndërkaq Vuçiqi tha se në këtë takim kanë hapur edhe temën e asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Një ditë më parë presidenti Hashim Thaçi, në një konferencë për media, ka thënë se marrëveshja e 4 shtatorit në Shtëpinë e Bardhë ka konfirmuar përkushtimin e ShBA-së për përkrahjen e Kosovës. Ai ka thënë se marrëveshja për normalizim ekonomik në mes të Kosovës dhe Serbisë është ndërmarrja diplomatike më serioze e ShBA-së në Ballkan.

Thaçi e ka falënderuar administratën Trump që gjatë këtyre viteve i ka qëndruar pranë shtetit të Kosovës. "Mirënjohje për ShBA-në që gjithmonë na ka qëndruar pranë. Në të gjitha takimet që kam zhvilluar katër vjet me presidentin Trump më ka folur për një vend dhe popull të mrekullueshëm. Javën e kaluar ishte një konfirmim i kësaj përkrahje. Ndihem i lumtur dhe krenar që pas përpjekjeve dhe punës së përbashkët për dy vjet me presidentin Trump, të premten arritëm të formalizohen këto përpjekje", ka deklaruar ai.

Presidenti Thaçi përsëri ka ftuar lidershipin e Kosovës për unitet rreth procesit të dialogut. "Nuk mund të bëhet asnjë hap më tutje pa unitet politik pozitë-opozitë sepse vendi është i të gjithëve. Vetëm kontributi i përbashkët i të gjithëve mund të rezultojë me sukses për vendin tonë, veçanërisht në procesin për implementimin e kësaj marrëveshjeje. Ne të gjithë kemi kërkuar çdoherë të ketë rol udhëheqës lidershipi i ShBA-së. Kjo ka ndodhur. Nuk bën të lejojmë që mentaliteti tribal të ndikojë në vonesa që Kosova po i paguan shumë shtrenjtë", ka deklaruar Thaçi.



## Gjini: Dialogu Kosovë - Serbi, pika më ndjeshme në këtë koalicion

**Prishtinë, 8 shtator** - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ardian Gjini, ka thënë se në mbledhjen e strukturave të kësaj partie të martën, nuk është diskutuar për dalje nga koalicioni qeverisës. Ai ka thënë se në këtë mbledhje tema e vetme ka qenë dialogu me Serbinë. "E falënderoj ShBA-në për arritjen e kësaj marrëveshje. AAK-ja insiston që disa çështje të shihen edhe një herë. Kemi kërkuar që të arrihet edhe më shumë në dialog. Vetëm dialogun sot e kemi pasur pikë të rendit të ditës. Kosova duhet të përgatitet më mirë. Ka pasur diskutime, por sot e vetmja pikë që është diskutuar ka qenë dialogu, pra kjo mund të jetë e vetmja pikë e diskutueshme brenda koalicionit. Dialogu është pika më ndjeshme në këtë koalicion", ka thënë Gjini.





FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI

# KRITIKAT E OPOZITËS PËR MARRËVESHJEN E UASHINGTONIT JANË TË DREJTA, POR NUK JANË REALE

Politologu Ramush Tahiri e ka vlerësuar historike marrëveshjen në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se marrëveshja e nënshkruar më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë e ka fuqizuar ndërkombëtarisht Republikën e Kosovës. Tahiri ka thënë se ky dokument i trajton plotësisht të barabartë Kosovën dhe Serbinë. Sipas tij, në këtë marrëveshje Serbia asgjë nuk ka më shumë se Kosova. Duke folur për kritikat e opozitës në raport me këtë marrëveshje, Tahiri ka theksuar se kritikat e opozitës janë të drejta, por nuk janë reale pasi, sipas tij, edhe kjo opozitë po të ishte në pushtet nuk do të mund të bënte më shumë

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 8 shtator** - Politologu Ramush Tahiri ka deklaruar se marrëveshja e Uashingtonit e ka fuqizuar ndërkombëtarisht Republikën e Kosovës. Ai këtë marrëveshje e ka cilësuar historike për disa arsye. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Tahiri ka thënë se për herë të parë në një nivel kaq të lartë Kosova është paraqitur e barabartë me Serbinë. "Kjo marrëveshje është historike për faktin se është nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë. Është historike sepse Kosova për herë të parë në arenën ndërkombëtare përfaqësohet në nivel kaq të lartë me një dokument të tillë. Gjithashtu, kjo marrëveshje është historike sepse për herë të parë Kosova nënshkruan diçka të këtij niveli me Serbinë ku përfshihet zhvillimi ekonomik, por edhe parimet e tjera të subjektivitet ndërkombëtar të Kosovës, siç ishte lufta kundër terrorizmit, hapja e Ambasadës në Jerusalem dhe gjëra të tjera", ka thënë Tahiri.

Ai ka numëruar përfitimet që Kosova ka marrë nga kjo marrëveshje, duke thënë se kritikat ndaj këtij dokumenti janë joreale. "Sa iu përket përfitimeve, Kosova përfiton shumë sepse aty përfshihen marrëveshje ekonomike që tërheqin miliarda dollarë. Gjithashtu, do të ketë edhe kredi të buta dhe investime kapitale nga amerikanët. Pra, parashihet ndërtimi i hekurudhës Nish-Durrës, ndërtimi i autostradës Nish-Durrës dhe do të ketë ndërtim të një porti të ri në Shqipëri. Sigurisht se do të jetë porti i Shëngjinit, ku do të ketë qasje edhe Serbia. Gjithashtu, aty përfshihet edhe njohja nga Izraeli dhe gjëra të tjera", është shprehur Tahiri.

Njohësi i rrethanave politike ka bërë me dije se në këtë marrëveshje Kosova dhe Serbia paraqiten plotësisht si dy shtete të barabarta. "Ky dokument është marrëveshje mirëbesimi i cili njihet si akt ndërkombëtar. Ajo nuk është marrëveshje klasike trepalëshe, mirëpo i ka të gjitha elementet që Kosovën e trajton të barabartë me Serbinë. Me këtë marrëveshje asgjë Serbia nuk ka më shumë se Kosova", ka vlerësuar Tahiti.

**"Epoka e re":** *Z. Tahiri, cili është vlerësimi juaj për marrëveshjen në Uashington?*

**Tahiri:** Marrëveshja është historike për Kosovën. Është historike për faktin se është nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë. Është historike sepse



Kosova për herë të parë në arenën ndërkombëtare përfaqësohet në nivel kaq të lartë me një dokument të tillë. Gjithashtu, kjo marrëveshje është historike sepse për herë të parë Kosova nënshkruan diçka të këtij niveli me Serbinë ku përfshihet zhvillimi ekonomik, por edhe parimet e tjera të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, siç ishte lufta kundër terrorizmit, hapja e ambasadës në Jerusalem dhe gjëra të tjera. Ky dokument është marrëveshje mirëbesimi i cili njihet si akt ndërkombëtar. Ajo nuk është marrëveshje klasike trepalëshe, mirëpo i ka të gjitha elementet që Kosovën e trajton të barabartë me Serbinë. Me këtë marrëveshje asgjë Serbia nuk ka më shumë se Kosova.

**"Epoka e re"**: *Cilat janë përfitimet e kësaj marrëveshje për Kosovën?*
**Tahiri:** Sa iu përket përfitimeve, Kosova përfiton shumë, sepse aty përfshihen marrëveshje ekonomike që tërheqin miliarda dollarë. Gjithashtu, do të ketë edhe kredi të buta dhe investime kapitale nga amerikanët. Pra, parashihet ndërtimi i hekurudhës Nish - Durrës, ndërtimi i autostradës Nish - Durrës dhe do të ketë ndërtim të një porti të ri në Shqipëri. Sigurisht se do të jetë porti i Shëngjinit, ku do të ketë qasje edhe Serbia. Gjithashtu, aty përfshihet edhe njohja nga Izraeli dhe gjëra të tjera.

**"Epoka e re"**: *Për këtë marrëveshje ka pasur edhe kritika që kanë pasur të bëjnë me lëshimet që i ka bërë Kosova në raport me Serbinë. Si i keni parë këto kritika?*
**Tahiri:** Kritikat ndaj kësaj marrëveshje nuk po i shoh. Pra, ato nuk po dua t'i shoh. Unë e kam lexuar dokumentin me njohurinë time. Aty të njeh Izraeli, duke e hapur ambasadën në Jerusalem. Mendoj se Kosova me këtë njohje fiton, nëse nuk e humbet Turqinë. Ashtu siç tha presidenti, besoj se Turqia do të na kuptojë nevojën tonë për ta na njohur Izraeli.

**"Epoka e re"**: *Kritikat e opozitës për këtë marrëveshje kanë të bëjnë me faktin se nuk ndodhi njohja reciproke?*
**Tahiri:** E kam parë këtë kritikë të opozitës, e cila thotë se kryeministri para takimit ka thënë se po shkon për njohje. Është fakt se nuk ndodhi njohja reciproke se, po të ndodhte, atëherë të gjithë marrëdhëniet do të rregulloheshin ndryshe. Madje njohja nuk po bëhet as në Bruksel. Synim i gjithë këtyre proceseve është njohja. Në Bruksel, në deklaratën e përbashkët të BE-së, para kryeministrit Avdullah Hotit dhe presidentit serb Aleksandër Viçiq, u tha se të gjitha bisedimet kanë për qëllim bërjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Këtë fakt unë e përkthej vetëm si njohje.

**"Epoka e re"**: *A do të thotë kjo se kritikat e LV-së dhe të PDK-së për mospërfshirjen e njohjes në këtë marrëveshje janë joreale?*
**Tahiri:** Politikisht ato kritika janë të drejta, mirëpo nuk janë reale. Bisedimet po zhvillohen në Bruksel, ku po thuhet se do të diskutohen të gjitha temat, por asnjë temë nuk është e përfunduar derisa të bëhet marrëveshja gjithëpërfshirëse. Pra, kritikat e opozitës janë të drejta në parim, por nuk janë reale, sepse edhe opozita po të ishte në pushtet nuk do të mund të bënte më shumë. Pajtohem me atë që thotë presidenti, se jemi vonuar në këtë drejtim. Kjo marrëveshje është dashur të bëhet më herët, por jemi vonuar për shkak të përçarjeve tona.

**"Epoka e re"**: *Cilat do të jenë ndikimet e kësaj marrëveshje? Sa do të ndikojë kjo në procesin e Brukselit?*
**Tahiri:** Kjo marrëveshje natyrisht se do të ketë ndikim në procesin e Brukselit. Tash edhe Brukseli duhet të konkurrojë. BE-ja nuk e njeh Kosovën si shtet, madje ende Kosovës nuk i janë liberalizuar vizat. Në këtë drejtim besoj se kjo marrëveshje do ta ketë ndikimin e vet. Amerika është përcaktuar për strategjinë e zhvillimit ekonomik. Pra, duke parë se nëse dy vendet bashkëpunojnë ekonomikisht, integrohen më lehtë në BE. Nëse hyjnë 10 miliardë dollarë investime, atëherë hapen vende pune. Në këtë mënyrë përgatiten ekonomitë e të dy shteteve për t'u integruar në BE. Me këto dakordime, marrëveshja e Uashingtonit në aspektin gjeostrategjik e largon ndikimin rus në rajon. E kemi parë se ka një përplasje mes presidenti Vuçiq dhe Rusisë. Gjithashtu, përmes asaj pikës për 5G, e largon ndikimin kinez.

**"Epoka e re"**: *Sipas kësaj që po thoni, i bie se përmes kësaj marrëveshje Kosova është fuqizuar ndërkombëtarisht?*
**Tahiri:** Natyrisht se shteti i Kosovës me këtë marrëveshje është fuqizuar ndërkombëtarisht. Kosova në pesë vjetët e fundit pati mbetur mbrapa sepse nuk e vizitonte askush. Pastaj, filluan të tallen zyrtarët evropianë me Kosovën. I kemi parë zyrtarët e lartë evropianë që vinin për vizitë dhe thoshin se liberalizimi i vizave nuk do të ndodhë deri në vitin 2021, ndërsa ne kemi plotësuar të gjitha kriteret. Institucionet e BE-së, vendet anëtare, nuk bëjnë asgjë për të biseduar me pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën. Me këtë marrëveshje besoj se ShBA-ja fuqimisht po kthehet në raport me Kosovën. Në këtë aspekt, për mua është më e rëndësishme që Kosova të bëhet anëtare e Kombeve të Bashkuara sesa të na njohë Serbia.

# LV-ja: Marrëveshja e Uashingtonit shkel Kushtetutën

Prishtinë, 8 shtator - Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë kritikuar marrëveshjen për normalizim ekonomik midis Kosovës dhe Serbisë, të nënshkruar në Uashington, duke thënë se disa nga pikat e saj janë gabim dhe shkelin Kushtetutën e Kosovës.
"Për herë të parë një kryeministër i papërgjegjshëm u pajtua që Ujmani të jetë pjesë e negociatave me Serbinë. Resurset e Kosovës janë të patjetërsueshme. Këtë e përcakton edhe Kushtetuta e Kosovës. Ai që mendon se mund t'i japë resurse Serbisë, ai e bën një krim të madh", ka thënë Glauk Konjufca nga Lëvizja Vetëvendosje në një konferencë për media.
Albulena Haxhiu, po nga Lëvizja Vetëvendosje, ka pohuar se në pikën 7 të marrëveshjes përmendet termi "ndarje" për Liqenin e Ujmanit. "Termi ndarje që është përdorur në këtë marrëveshje ka kuptimin e pjesëmarrjes së Serbisë në pronësinë, kontrollin dhe menaxhimin e një pjese të këtij liqeni", ka thënë Haxhiu. Sipas saj, kjo pikë e marrëveshjes është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, përkatësisht me nenin dy, paragrafin dy.
Konjufca tha se marrëveshja e Uashingtonit përmban pika që, sipas tij, i ka shtyrë përpara presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq. "Përse Qeveria e Kosovës pranon që të pezullohen përpjekjet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare? Ky është një lëshim i madh. Neni 17, pika 1 e Kushtetutës së Kosovës, thotë se Kosova anëtarësohet në organizata ndërkombëtare. Nënshkrimi i Hotit e shkel Kushtetutën e Kosovës", ka thënë Konjufca.
Në pikën e 15-të të marrëveshjes thuhet se Kosova pajtohet që ta zbatojë një moratorium njëvjeçar mbi kërkesat e saj për anëtarësim të ri në organizata ndërkombëtare. Serbia, në këmbim, do të zbatojë një moratorium njëvjeçar mbi fushatën e saj për çnjohje të Kosovës.
Në një pikë të marrëveshjes,




Kosova po ashtu pajtohet t'i bashkohet zonës së mini-Shengenit, një nismë kjo për bashkëpunim ekonomik rajonal, që është shpallur nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, në tetor të vitit të kaluar.
Atëbotë Kosova e ka kundërshtuar pjesëmarrjen në të. "Gatishmëria e kryeministrit Hoti që të hyjë në zonën e lirë ekonomike, të propozuar nga Serbia është, po ashtu, një gabim i madh", ka thënë Konjufca, për të shtuar se është "ëndërr e Serbisë për ta hequr kufirin në mes të Kosovës dhe Serbisë pa e njohur Kosovën".
Konjufca paralajmëroi hapa për mocion për rrëzimin e Qeverisë së Kosovës.

# Dumoshi takon anëtarët e grupit punues për shndërrim në muze të ish-Burgut të Prishtinës

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka pritur të martën në takim konstituiv anëtarët e grupit punues për shndërrim në muze të ish-Burgut të Prishtinës. Në takim ministrja Dumsohi u shpreh e lumtur që në mandatin e vet si ministre ish-Burgu i Prishtinës filloi procedurat e shndërrimit në muze. "Burgu i Prishtinës ishte vendi ku shumë figura të rëndësishme të vendit tonë janë burgosur e persekutuar politikisht, prandaj shndërrimi i tij në muze është i domosdoshëm për kujtesën tonë kolektive dhe për njohjen e kontributit të shumë njerëzve në Kosovë", ka thënë Dumoshi. Ajo ka theksuar se trashëgimia kulturore e shpirtërore dhe ruajtja e kujtesës kolektive janë prioritete kyçe të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ndërtesa në të ardhmen do të menaxhohet dhe administrohet nga MKRS-ja me funksionin muze. Gjatë takimit anëtarët e grupit punues thanë se do të angazhohen maksimalisht duke pasur në konsideratë ndjeshmërinë e çështjes, kompleksitetin e ndërtesës, si dhe aspektin shoqëror dhe historik të saj.



GRUPI PUNUES ME VENDIM TË MINISTRES KA KËTË PËRBËRJE:

Vjollca Aliu, drejtoreshë e Departamentit të Trashëgimisë në rolin e kryesueses.
Ndërkaq në rolin e anëtarëve:
Profesor Luan Mulliqi, anëtar korrespodent i Akademisë;
Bislim Zogaj, drejtor i AMKMK-së;
Xhavit Loshaj, këshilltar i ministrit të Drejtësisë;
Hydajet Hyseni, kryetar i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës;
Meriman Braha, drejtor ekzekutiv i Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës;
Fikrije Berisha, zyrtare e Agjencisë së Arkivave të Kosovës dhe
Hagji Ademi, Instituti i Historisë dhe
Ajshe Kamberi, MPB.

# Testi i maturës, afati i dytë, do të mbahet më 10 tetor



PRISHTINË, 8 SHTATOR (ER) - Këshilli Shtetëror i Maturës (KShM) ka mbajtur të martën takimin e radhës, në të cilin është diskutuar për afatin e dytë të Maturës Shtetërore 2020 dhe është vendosur që data 10 tetor 2020 të jetë dita e mbajtjes së Testit të Maturës për afatin e dytë.
Kryetari i KShM-së, Gëzim Berisha, ka bërë me dije se nga data 15-24 shtator maturantët e mbetur për afatin e dytë do të mund ta paraqesin testin, rezultatet e të cilit do të bëhen publike më 16 tetor 2020. Ai ka theksuar se, më pas, nga data 19-21 tetor do të jetë afati i ankesave, rezultatet e të cilave, pas shqyrtimit, do të publikohen më 23 tetor, për ta shënuar kështu përfundimin e gjithë procesit të maturës shtetërore për këtë vit.
Në afatin e parë të maturës shtetërore testin e kanë kaluar 17 105 nxënës nga 25 362 sa kanë marrë pjesë në test, ndërsa për 8 257 maturantë mbetet si mundësi edhe afati i dytë i provimit të maturës.

# Emërohet këshilli i ri i QKK-së

PRISHTINË, 8 SHTATOR (ER) - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka pritur të martën në takim drejtorin e QKK-së, Arben Zhurku dhe anëtarët e rinj të Këshillit Drejtues të Qendrës Kinematografike të Kosovës.
Këshilli Drejtues i Qendrës Kinematografike të Kosovës ka këtë përbërje: Arbnesha Grabovci; Jeton Zogjani; Luan Daka; Linda Shala dhe Burim Reçica, përfaqësues i MKRS-së.
Gjatë këtij takimi ministrja Dumoshi i njoftoi anëtarët e rinj të këshillit drejtues për gjendjen aktuale të kinematografisë si dhe për sfidat nëpër të cilat po kalon aktualisht QKK-ja. Ajo ka thënë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të përkrahë në vazhdimësi QKK-në si nga ana profesionale, po ashtu edhe nga ajo financiare.
Po në takim u diskutua edhe për ligjin e ri të QKK-së i cili së shpejti do të kalojë në qeveri për aprovim.
Drejtori i QKK-së, Arben Zharku, i uroi anëtarët e rinj dhe i njoftoi për punën dhe sfidat nëpër të cilat do të kalojnë.



## Në Mitrovicë pezullohen përkohësisht shërbimet për vula apostile

MITROVICË, 8 SHTATOR (ER) - Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Agjencia për Regjistrim Civil, njofton qytetarët e Komunës së Mitrovicës, se janë pezulluar përkohësisht shërbimet për vula apostile/verifikuese në këtë komunë. "Arsyeja e këtij pezullimi është për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore dhe dyshimit të infektimit me Covid-19 të njërit prej zyrtarëve të ARC-së në Mitrovicë, punonjës në sektorin për vula apostile. Qytetarët e Komunës së Mitrovicës do të informohen me kohë se kur do të rifillojë puna në këtë shërbim", theksohet në njoftimin e MPB-së.



# Asnjë viktimë nga Covidi gjatë 24 orëve në Kosovë




**Autoritetet shëndetësore në Kosovë nuk kanë regjistruar asnjë viktimë me Covid-19 në 24 orët e fundit. Nga testimi i 481 mostrave, 97 pacientë kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka njoftuar se brenda 24 orëve janë shëruar edhe 139 pacientë. Me këto shifra, numri i përgjithshëm i të prekurve me Covid në Kosovë arrin në 14 301**

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 SHTATOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), me metodën RT-PCR dhe në laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 481 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 97 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve nuk janë raportuar raste të vdekjes me Covid.

Numri total i rasteve pozitive është 14 301 raste nga 54 924 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 568 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 139 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 10 782 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 951.

Rastet pozitive brenda 24 orëve të fundit janë nga: komuna Prishtinë 27 raste, komuna Gjilan 8 raste, komuna Klinë 8 raste, komuna Pejë 8 raste, komuna Gjakovë 5 raste, komuna Vushtrri 5 raste, komuna Drenas 4 raste, komuna Fushë Kosovë 4 raste, komuna Mitrovicë 4 raste, komuna Obiliq 4 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Kamenicë 2 raste, komuna Lipjan 2 raste, komuna Podujevë 2 raste, komuna Prizren 2 raste, komuna Rahovec 2 raste, komuna Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Hani i Elezit, Shtime, Skenderaj, Suharekë dhe Zubin Potok.

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar po këtë ditë se në institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht janë të shtrirë 362 pacientë, prej tyre 257 janë të prekur me Covid-19.

Në raportin ditor të ShSKUK-së është thënë se gjashtë pacientë janë në respiratorë, 18 janë duke u trajtuar me makinat e frymëmarrjes CPAP, kurse 234 të tjerë janë në oksigjenoterapi.

Kosova ka gjithsej 700 shtretër në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale.

### Zemaj: Nuk do të zbehet përkushtimi im dhe i personelit mjekësor në luftë me pandeminë

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se Kosova sot po shënon zero raste të vdekjeve të pacientëve të infektuar me Covid-19. "Një lajm që padyshim na bën të ndihemi mirë, por assesi që ta zbehë përkushtimin tim si ministër, as të personelit mjekësor dhe të të gjithë aktorëve të tjerë të përfshirë në luftën me pandeminë", ka thënë Zemaj, i cili të martën ka qëndruar në qytetin e Klinës, ku është takuar me kryetarin Zenun Elezaj.

Zemaj ka vizituar edhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në këtë komunë, ku me drejtorin e kësaj qendre, Anton Shllaku, kanë biseduar për shqetësimet që ka krijuar ky virus, për menaxhimin e situatës si dhe për projektet që do të realizojnë në të ardhmen. "Kjo QKMF do ta ketë përkrahjen time, do të mbështeten projekte të caktuara e do të ofrohet ndihmë për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. E falënderova stafin menaxhues dhe personelin shëndetësor për përkushtimin dhe punën e palodhur që janë duke bërë në këtë kohë të vështirë", ka thënë Zemaj.

## Së shpejti do të bëhet realitet funksionalizimi i Spitalit të Podujevës

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se së shpejti do të bëhet realitet funksionalizimi i Spitalit të Podujevës dhe ndërtimet shtesë sipas plan-projektit. "Së shpejti do të bëhet realitet funksionalizimi i Spitalit të Podujevës dhe ndërtimet shtesë sipas plan-projektit, për këtë sapo biseduam me Agim Veliun, ministër i Punëve të Brendshme dhe Nexhmi Rudarin, nënkryetar i Podujevës. Gjatë takimit të sotëm për këtë projekt elaboruam në hollësi se si të funksionalizohet pa vonesa, i cili është i bazuar në nevojat dhe kërkesat e kësaj komune", ka thënë Zemaj pas takimit. Ai ka bërë me dije se në këtë takim kanë folur edhe për prioritetet aktuale të qeverisjes së institucioneve qendrore dhe lokale, për situatën epidemiologjike si dhe menaxhimin në Komunën e Podujevës. Zemaj ka theksuar se me Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe me autoritetet e Komunës së Podujevës kanë koordinim të shkëlqyeshëm ndërinstitucional. "Së bashku edhe me aktorët e tjerë po angazhohemi maksimalisht për ta tejkaluar situatën e pandemisë dhe për t'i realizuar projektet e parapara", ka deklaruar Zemaj.

## Haradinaj: Kosova është me fat që ka një vend mik si Mbretëria e Bashkuar

PRISHTINË, 8 SHTATOR (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, Nick Abbot. Haradinaj ka falënderuar ambasadorin Abbot për kontributin e vazhdueshëm dhe të jashtëzakonshëm që ka dhënë Britania e Madhe për lirinë, pavarësinë dhe zhvillimin e Kosovës. "Biseduam për të gjitha temat që sot e rrethojnë Kosovën, për bisedimet, sigurinë, për krizën me pandeminë, zhvillimin ekonomik e social dhe për tema të tjera. Kosova është me fat që ka një vend të tillë mik dhe mbështetës", ka thënë Haradinaj pas takimit.



# ATK-ja dhe Dogana vazhdojnë bashkëpunimin për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta



PRISHTINË, 8 SHTATOR (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, ka pritur të martën në takim u. d. drejtorin e Doganës së Kosovës, Ibrahim Xhaka, me bashkëpunëtorët e tij.
Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i vazhdimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në aktivitetet e përbashkëta për luftimin e ekonomisë joformale ku, veç të tjerash, gjatë këtij takimi drejtorët e dy institucioneve kryesore të të hyrave folën edhe për ndikimin e deritanishëm të pandemisë Covid-19 në performancën e këtyre dy institucioneve, e cila në masë të madhe ka goditur ekonominë e vendit tonë e, si rrjedhojë, deri më tani ka rënie të theksuar të qarkullimit të bizneseve, si dhe pagesës së detyrimeve tatimore dhe doganore.
Drejtorët e dy institucioneve theksuan rëndësinë e vazhdimit të bashkëpunimit si dhe koordinimin e aktiviteteve mes dy institucioneve kryesore për mbushjen e buxhetit të shtetit.

# Ndotja e mjedisit shkakton 13 për qind të vdekjeve në Evropë


Novka Ilić (RFE/RL)

Prishtinë, 8 shtator - Luftimi i ndotjes së mjedisit është kyç për përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve në Evropë, veçanërisht për grupet e ndjeshme si fëmijët, të moshuarit dhe njerëzit më të varfër, ka njoftuar Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA).
Ndotja e mjedisit u përmend si shkaktare e 13 për qind të vdekjeve në Evropë, duke kontribuar në sëmundje jongjitëse të tilla si kanceri dhe sëmundjet e zemrës.
Vlerësimi i EEA-së për shëndetin dhe mjedisin vuri në dukje se ndotja e ajrit ishte "faktori kryesor i mjedisit që nxit sëmundjet".
Mbi 400 000 vdekje të parakohshme çdo vit në BE janë pasojë e ndotjes së ajrit, tha agjencia me bazë në Kopenhagë, duke vënë në dukje lidhjet me sëmundjet e frymëmarrjes dhe kardiovaskulare.
Edhe zhurma në mjedis ka ndërlidhje me çështje të shumta shëndetësore, përfshirë sëmundjet e zemrës, madje edhe vdekjen e parakohshme.
Ekspozimi afatgjatë ndaj zhurmës mjedisore shkakton rreth 12 000 vdekje të parakohshme çdo vit në rajonin Evropian, ka njoftuar EEA, duke theksuar se transporti rrugor ishte një burim kryesor i zhurmës, transmeton DPA.
Autorja kryesore e raportit, Catherine Ganzleben, ka thënë se shumë sëmundje kronike jo vetëm që zvogëlojnë jetëgjatësinë dhe cilësinë e jetës së pacientit, ato gjithashtu paraqesin një barrë për familjet e tyre, komunitetet dhe sistemin shëndetësor.

# Si do të përdoret në mënyrë të përbashkët Liqeni i Ujmanit nga Kosova dhe Serbia?

**Prishtinë, 8 shtator** - Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar marrëveshje për normalizim ekonomik në Shtëpinë e Bardhë, në kuadër të së cilës, bashkë me amerikanët, parashihet hartimi i një studimi të fizibilitetit me qëllim të përdorimit të përbashkët të Liqenit të Ujmanit si furnizues i sigurt i ujit dhe energjisë. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në Shtëpinë e Bardhë më 4 shtator.

Liqeni i Ujmanit është më i madhi në Kosovë, i cili shtrihet në veri-perëndim të vendit, konkretisht në Komunën e Zubin Potokut, komunë kjo e banuar me shumicë serbe. Ky liqen ka sipërfaqe prej 11.9 kilometrash katrorë (nga të cilat 9.2 kilometra katrorë në territorin e Kosovës dhe 2.7 kilometra në territorin e Serbisë) dhe 370 milionë kub ujë.

Penda e Ujmanit është ndërtuar midis viteve 1970-1984. Hidrocentrali prodhon 35 megavat për orë energji elektrike, kurse kanali Ibër-Lepenc është 49 kilometra i gjatë dhe është ndërtuar me fonde të buxhetit të Kosovës.

Kanali Ibër - Lepenci kalon nëpër territorin e pesë komunave - Zubin Potok, Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë, duke kaluar nëpër 33 vendbanime rurale dhe dy qytete. Ky liqe menaxhohet nga ndërmarrja hidroekonomike "Ibër-Lepenc" me seli në Prishtinë, në pronësi të Qeverisë së Kosovës.

Kryeshefi ekzekutiv i kësaj ndërmarrjeje, Berat Lushtaku, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" tha se Liqeni i Ujmanit është në pronësi të Ibër-Lepencit edhe në pjesën e Kosovës dhe pjesën e Republikës, dhe për këtë thotë ai, ekzistojnë dokumentet e nevojshme. "Ne do t'i marrim të gjitha vendimet me bordin e drejtorëve dhe do të dalim me një konkluzion konkret sa i përket kësaj çështjeje. Aksionar 100 për qind është Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ata i kanë të drejtat mbi ne", tha Lushtaku.

Ky liqe artificial furnizon me ujë të pijshëm ujësjellësin e





Mitrovicës dhe atë të Prishtinës, kurse me ujë të papërpunuar, thotë Lushtaku, furnizon Korporatën Energjetike të Kosovës dhe kompaninë NewCo Ferronikeli që gjendet në Drenas, ndërsa për ujitje disa rajone të Kosovës.

Ndryshe, pjesëmarrësit në ekipin e ndërtimit të këtij liqeni e quajnë absurde marrëveshjen, ku thuhet për "përdorim të përbashkët të liqenit".

Halim Gjergjizi, i cili ka qenë pjesë e projektit në vitet '70, thotë se ky projekt në atë kohë është ndërtuar me kredi nga Banka Botërore, për të cilën ka garantuar shteti i ish-Jugosllavisë, kurse obligimet dhe marrëveshjet i kanë nënshkruar njësitë federale, në këtë rast Kosova. Ai thotë se liqeni është ndërtuar për nevojat e qytetarëve të Kosovës. "Është absurde që të paraqitet edhe një palë tjetër, çfarë është Serbia. Me gjithë dokumentet, gjithë historinë e ndërtimit të atij kapaciteti, Serbia nuk ka kurrfarë të drejte të shfrytëzimit ose të menaxhimit të atij sistemi. Ndoshta do të ketë sqarime më vonë lidhur me këtë marrëveshje, por tash për tash është absurde. Uji nuk mund të shkojë në Serbi për shfrytëzim. Serbia nuk mund ta shfrytëzojë ujin në mënyrë të përbashkët. Ai është i dedikuar për nevoja të Kosovës", tha Gjergjizi për "Radion Evropa e Lirë".

Sa i përket Liqenit të Ujmanit, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, në një konferencë për media nga Uashingtoni, tha se janë pajtuar që të bëhet një studim i fizibilitetit nga Departamenti i Energjisë të ShBA-së për këtë liqe. "Pra, Departamenti për Energji i ShBA-së, të bëjë një studim të fizibilitetit për Liqenin e Ujmanit për mënyrën se si do të përdoret uji i këtij liqeni në të ardhmen, si burim ujitje dhe si burim energjie. Vetëm kaq, kjo është e vërteta sa i përket kësaj çështje", ka thënë Hoti.

Në anën tjetër, në Zubin Potok ka një ndërmarrje në pronësi të Serbisë e cila quhet "Ibar" dhe është themeluar në vitin 2002 dhe që Kosovën e konsideron të paligjshme.

Vitet e fundit zyrtarë nga Beogradi insistonin të përvetësojnë këtë liqe, çka është kundërshtuar fuqishëm nga autoritetet zyrtare në Kosovë.

Madje më 8 shtator 2018, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, kishte vizituar Liqenin e Ujmanit (Gazivodës), ku kishte thënë se "Ujmani është një liqe shumë me rëndësi si për serbët ashtu edhe për shqiptarët". Andaj, sipas tij, është me rëndësi që të gjendet zgjidhje e pranueshme për të dyja palët.

Liqeni i Ujmanit nga Serbia dhe presidenti Vuçiq ishte cilësuar si burim dhe pasuri ekonomike serbe, gjë që kundërshtohet ashpër nga autoritetet në Prishtinë.

# Qeveria e Kosovës vazhdon përkrahjen për sektorin e qumështit

**Prishtinë, 8 shtator (ER)** - Në vazhdën e takimeve të rregullta koordinuese dhe bashkëpunuese me shoqatat e prodhuesve dhe të industrisë së përpunuesve të qumështit, duke përfshirë edhe takimin e së martës, po punohet intensivisht drejt tejkalimit të sfidave me të cilat po ballafaqohet sektori i qumështit në vendin tonë si rezultat i pandemisë Covid-19.

"Prodhuesit dhe përpunuesit kosovarë të qumështit janë ndër bujqit më të zellshëm në vendin tonë që me përkrahjen e institucioneve vendore dhe ndërkombëtarë kanë ndërtuar kapacitete prodhuese dhe përpunuese për t'u shërbyer qytetarëve kosovarë me qumësht dhe produkte të qumështit. Ne do të jemi vazhdimisht pranë tyre, edhe në këto kohë të vështira të pandemisë Covid-19 për t'u ndihmuar për tejkalimin e sfidave me mundësitë ligjore, administrative dhe financiare që kemi në dispozicion", kështu është thënë në njoftimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.



# Kuvendi i Gjilanit i ridestinoi në investime kapitale mjetet prej 1.4 milion eurosh të planifikuara për paga

Gjilan, 8 shtator (ER) - Kuvendi Komunal i Gjilanit, në një seancë të jashtëzakonshme, kryesuar nga Shpresa Kurteshi-Emini, ka miratuar transferimin e mjeteve financiare nga kategoria e shpenzimeve në kategorinë e investimeve kapitale, ku sqarimet e nevojshme i ka dhënë Ilmi Limoni, zyrtar i lartë financiar.
Ai ka thënë se këto mjete në planifikimin fillestar kanë qenë të ndara te kodi i rezervave, me qëllim që të derdheshin në fondin për paga por, siç dihet, Gjykata Kushtetuese e ka anuluar ligjin për paga, prandaj me rishikim është lejuar që këto mjete të ridestinohen tek investimet kapitale në komuna.
Limoni kërkoi nga këshilltarët komunalë që ta mbështesin këtë ridestinim të shumës mbi 1.4 milion sepse do të shfrytëzohen për të mirën e qytetarëve të Gjilanit.
Këshilltarët komunalë, me 20 vota për dhe 5 kundër, e kanë miratuar transferimin, por opozita, LV-ja dhe një pjesë e PDK-së patën vërejtje për mënyrën e shpërndarjes së këtyre mjeteve, duke thënë se është dashur të orientohen në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, duke marrë parasysh edhe gjendjen e pandemisë dhe jo në kulturë, rrugë të rendit të tretë e të tjera.
Arbër Ismajli, nënkryetar i komunës, tha se këto mjete janë ndarë në pajtim të plotë me të gjithë drejtorët komunalë, kryesisht me ata që kanë pasur më shumë nevojë për përmbushjen e planeve të tyre, meqë disa projekte kanë ngelur mbrapa si pasojë e pandemisë.



# Kastrati, i vendosur për ndërtimin e objektit të ri të shkollës 'Fan S. Noli'



Kamenicë, 8 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me u. d. drejtoreshën e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Mirhane Morina-Bislimi, dhe zyrtarë nga Zyra për Investime dhe Mbështetje të Bizneseve (ZIMB), kanë takuar drejtoreshën e Departamentit të Shërbimeve Teknike në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Fadile Dyla dhe zyrtarë nga ky divizion.
Në këtë takim është diskutuar për ndërtimin e objektit të ri të shkollës "Fan S. Noli" në Kamenicë.
I pari i komunës, Qëndron Kastrati, ka falënderuar ministrinë për bashkëpunimin, duke thënë se ky projekt plotëson standardet evropiane.
"Kjo shkollë me 544 nxënës, projekti i së cilës plotëson normat dhe standardet evropiane, synon qëndrim tërëditor dhe shfrytëzim të mensës prej nxënësve serb dhe shqiptarë. Falënderoj ministrinë për bashkëpunimin", ka thënë Kastrati.

# Nënshkruhen marrëveshje inicimi për dy projekte në Komunën e Malishevës

Malishevë, 8 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë (FKEE), i përfaqësuar nga Admir Shala, drejtor menaxhues, nënshkruan marrëveshje inicimi për dy projekte në Komunën e Malishevës. Përfitues të këtyre projekteve do të jenë objekti i administratës komunale dhe Gjimnazi "Hamdi Berisha". Palët janë marrë vesh që ta iniciojnë implementimin e PKEE për këto projekte.
Për t'i realizuar këto projekte janë disa partnerë: FKEE, IDA, Programi i Partneritetit i Bankës Botërore dhe Programi i Fondi i Donatorëve të Mirëbesimit. Kjo marrëveshje vazhdon këtë vit me grupet punuese për hartimin e projektit dhe fillimin praktik të implementimit për vitin e ardhshëm.





# Mbahet takimi i parë i Task Forcës në nivel të qytetit të Pejës

Pejë, 8 shtator (ER) - Të martën është mbajtur takimi i parë i Task Forcës në nivel të qytetit të Pejës, në të cilin janë diskutuar rregullativat e udhëzuesit të Ministrisë së Shëndetësisë. Komuna e Pejës ka njoftuar se kjo Task Forcë është zotuar se do ta mbikëqyrë zhvillimin e procedurave për fillimin e vitit të ri shkollor, duke marrë të gjitha masat parandaluese sipas zbatimit të rregullave kundër Covid-19 dhe nga e mërkura do të bëhet monitorimi i të gjitha shkollave në mënyrë që të shihet gatishmëria e tyre për fillimin e vitit të ri shkollor.
Plani i Punës së Task Forcës është formuar dhe do të bëhen vizita të rregullta në të gjitha shkollat, ndërsa takime do të ketë çdo javë.

# LUFTË ABSURDE PËR KARRIGEN E ZËNË TË PRESIDENTIT

**Karrigia e presidentit është e zënë edhe kur formalisht është bosh ngaqë në çdo variant në të e vendosin dikë që nuk e ka miratimin e popullit**



Milazim KRASNIQI

Shprehja podrimase "Lumi tue u shterë, njerëzit tue u mbytë" e shprehë shumë mirë gjendjen absurde që mbretëron në të gjithë jetën politike në Kosovë, veçmas lidhur me zgjedhjen e presidentit të ardhshëm. Pra, kuptimi është se nëse një lumë ka pak ujë dhe po shteron, ndërsa njerëzit po mbyten edhe më shumë në të, kjo paraqet absurditet, paraqet budallallëkun e tyre. E, pra, në ditët kur Kosova është në ankth nga presionet e Gjykatës Speciale, e cila thjesht po ia merr frymën këtij vendi, në ditët kur pandemia po bën kërdi, në ditët kur qeveria po dridhet nga kalkulimet hileqare të partive të koalicionit, në ditët kur varfëria dhe mjerimi po shtohen, në ditët kur pozita ndërkombëtare e Kosovës është degraduar në diskutime për bashkëpunim ekonomik me Serbinë, debati kryesor po zhvillohet se kush do të ulet në karrigen e zënë të presidentit. Thënë thjesht, sa më shumë që shteti po e gërryen substancën e vet dhe po rrëshqet drejt dështimit, aq më shumë po ndizet lufta për pushtet, ngjashëm si në shprehjen "lumi tue u shterë, njerëzit tue u mbytë!"

### Aktorët e debatit të parakohshëm

Po të mos kishte humbur logjika, siç realisht ka humbur në pjesën më të madhe të elitës sonë rural-politike, diskutimet për postin e presidentit nuk do të duhej të bëheshin fare në këtë periudhë. Pse? Sepse presidenti në detyrë i ka edhe tetë muaj deri sa ta përfundojë mandatin, ashtu që nëse e heqin para kohe me kalkulime partish, i bie që bëjnë një lloj puçi politik. E dyta dhe më e rëndësishmja në këtë mes, hapja e këtij debati për presidentin e ri, po e stimulon vendimin e Gjykatës Speciale, si vendim i cili po rekomandohet t'ia hajë kryet presidentit aktual dhe ashtu t'ua hapë rrugën pretendentëve që po ulërasin: o burra, muleni t'ia zëmë karrigen! Kushdo që participon në këtë farsë, realisht shprehë gëzim për eliminimin eventual politik të presidentit, me të gjithë konsekuencat që mund të ketë një eliminim me vendime gjykate penale, për historinë dhe për të sotmen e vendit tonë.

Edhe pse hapja e debatit i ka këto absurditete brenda vetes, absurditet edhe më të madh paraqet fakti se kush është involvuar në këtë debat. Ndonëse mund të ketë edhe aktorë të tjerë që do të inkuadrohen në ditët dhe javët në vijim në këtë debat, ata që tashmë janë involvuar, po e zbulojnë mjaftueshëm degradimin politik që ka pllakosur këtë vend. I pari që e ngriti këtë temë është ish kryeministri Ramush Haradinaj. Në fillim e aktivizoi aparatin e partisë e pastaj vetë deklaroi se nëse nuk zgjidhet president, do ta rrëzojë qeverinë. Në ditët në vijim u lansua propozimi që edhe një tjetër kryetar partie aleanciste, Behgjet Pacolli (AKR), të jetë kandidat për president. Pastaj kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, deklaroi se familja Jashari mund ta pranojë atë përgjegjësi nëse qytetarët dhe populli ua kërkojnë. Ndërsa LDK-ja, së fundi, doli me qëndrimin që pozita e presidentit i takon asaj partie. Një aktivist i LDK-së ka propozuar emrat e akademik Rexhep Ismajlit dhe të shkrimtarit Jusuf Buxhovi. Nëse vazhdohet me këtë logjikë, do të ketë edhe shumë propozime e kushtëzime të tjera, ashtu që kur të vijë koha për ta zgjedhur përnjëmend presidentin, në sallën e parlamentit mund të ketë më shumë kandidatë sesa deputetë.

Edhe më provokuese më duket pyetja se për çka po bëhet gjithë kjo garë? Mua më rezulton që gara po zhvillohet jo vetëm për një karrige që tash për tash është e zënë, por për një karrige që, për sa i përket pushtetit, është bosh edhe kur është formalisht e zënë. Pse? Sepse Kosova është një vend që de jure administrohet nga faktorë ndërkombëtarë, brenda temave të Marrëveshjes Teknike-Ushtarake të Kumanovës, të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Planit Gjithëpërfshirës të Marti Ahtisarit, EULEX-it dhe Gjykatës Speciale. Në termat e këtyre dokumenteve dhe pushteteve, Kosova nuk është shtet i pavarur e, aq më pak, sovran. Fjala vjen, KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut kanë të drejtë të bëjnë arrestime, EULEX-i dhe Gjykata Speciale kanë mandat të bëjnë gjykime, ndërsa Këshilli i Sigurimit në çdo tre muaj e diskuton dhe miraton raportin për Kosovën, të cilin e paraqet sekretari i OKB-së. Prandaj, as presidenti i Kosovës nuk është president tamam, sikundër që as shteti ynë nuk është ende shtet tamam.

### A trajtohet Kosova si shtet nga shtetet që e kanë njohur

Nganjëherë pozita e presidentit të Kosovës më duket e ngjashme me pozitën e presidentit të Qipros së Veriut. Njërin nga ata president e kam takuar në vitin 2010, më duket, në një aktivitet universitar në Girne. Ai ndiqte çdo aktivitet të brendshëm atje, mëhallë më mëhallë, sepse askush nuk i vinte në vizitë dhe askush nuk e ftonte askund. Natyrisht, Kosova është shumë më shumë shtet sesa Qiproja e Veriut, por jo aq sa është Qiproja e Jugut, e cila është anëtare e Bashkimit Evropian. Në fakt, Kosovën nuk e trajtojnë si shtet as shumica e shteteve që e kanë njohur dhe të cilat ne i quajmë aleatë e miq. Ka raste që ndonjë kryeministër ose kryetar i ndonjë shteti evropian vjen në vizitë në Kosovë, viziton forcat e veta në kuadër të KFOR-it dhe kthehet pa e takuar asnjë zyrtar shtetërorë të Kosovës. Në këtë kuptim, pra, nuk kryen punë emërtimi i funksionit ose institucioni (president/presidencë), por fuqia e tij, ashtu si thotë Fukujama: "forca e institucioneve shtetërore është në një kuptim të gjerë më e rëndësishme sesa shtrirja e funksioneve shtetërore". Në rastin tonë shihet se funksionet pa fuqi realisht janë karikaturë e pushtetit. Ndjekja nga Gjykata Speciale e presidentit derisa është në detyrë, është tregues i mungesës së fuqisë dhe, faktikisht, i kotësisë së ushtrimit të një posti, pa pasur fuqi në pajtim me postin. Vizitat e presidentit aktual nëpër familje të dëshmorëve e të veteranëve dhe eksplorimi e postimi prej tij i bukurive natyrore të vendit, flet vetvetiu për një funksion pa fuqi. Për ta konkretizuar edhe një aspekt të këtij meditimi tim në këtë temë, po e ricitoj Fukujamën: "Një institucion i mirë shtetëror është ai që e shërben me transparencë dhe efikasitet nevojave të klientëve të tij - qytetarëve të shtetit". E, pra, institucioni shtetëror që varet nga instanca të tjera të pushtetit ndërkombëtar (nga Marrëveshja Teknike-Ushtarake e Kumanovës, nga rezoluta 1244, nga Plani i Ahtisarit, nga EULEX-i, nga Gjykata Speciale) as nuk mund të jetë transparent e as efikas për qytetarët e shtetit. Atij i duhet të manovrojë, të manipulojë, ashtu që në sytë e qytetarëve të duket i fortë, ndërsa përballë protektorëve të sillet si pulë e lagur. Miratimi i Gjykatës Speciale nga ana e institucioneve të Kosovës është shembulli më tipik i sjelljes si pulë e lagur. Pavarësisht të gjitha këtyre sa u thanë, pra edhe po të ishte Kosova me shtetësi të përmbyllur, gara do të duhej të ishte më korrekte sesa kjo që sapo ka filluar. Si fillim, gara do të duhej të shpallej brenda rregullave dhe afateve kushtetuese, në mënyrë që t'u jepej mundësia të gjitha partive e të gjithë aktorëve relevantë që të participojnë në një proces mirëfilli demokratik. E dyta, gara nuk do të duhej të kishte asnjë ngjyrim lokal, as fisnor madje as të meritokracisë së gjeneratave të kaluara. Një president që zgjidhet nuk mund ta ushtrojë funksionin duke u mbështetur në një bastion lokal a fisnor, pa formim kulminant akademik e politik, pa projekt të detajuar për orientimet strategjike të shtetit, si në politikën e brendshme, ashtu edhe në skenën ndërkombëtare. Në demokraci jo, në shtete me diktatura si ato në Lindjen e Mesme, po. Në rastin tonë, të një shteti që përpiqet ta përmbyllë shtetndërtimin, më së miri do të ishte që presidenti të zgjidhej nga populli. Populli mund të bëjë edhe zgjedhje të gabueshme, por në atë rast nuk ka kë ta fajësojë, por e rritë aftësinë që ta korrigjojë gabimin në të ardhmen e të mos mbetet peng i gabimeve të përsëritura, siç po ndodhë me popullin në Kosovë, por edhe me mbarë kombin tonë shqiptar. Lidhur me këtë aspekt, Gjovani Sartori konstaton: "Populli ka gjithmonë të drejtë, jo në kuptimin që nuk gabon kurrë, po në kuptimin që ai ka të drejtën të gabojë dhe se e drejta për të gabuar i takon atij për vete, në dëm të vet." Unë mendoj se këta që kanë shpërfaqur kandidaturat për president të Kosovës, nuk e kanë në hatër zgjedhjen e presidentit nga populli, madje as ata që thonë se e kanë në hatër. Këto janë figura me fuqi lokale, koniukturale që duan të bëhen president me matematika partish ose me narracione për të kaluarën heroike të të parëve të tyre. Asnjëra kandidaturë nuk ofron minimumin e garancive që një president i zgjedhur me aso matematikash, mund të jetë president i të gjithë qytetarëve dhe të punojë me transparencë dhe me efikasitet për qytetarët dhe ta afirmojë vendin në arenën ndërkombëtare.

### Paragjykime dhe manipulime të panevojshme

Meqë jemi tetë muaj larg afatit kur duhet të zgjidhet presidenti i Kosovës, por në të njëjtën kohë përballë një Gjykate Speciale, e cila mund ta shkurtojë atë afat nëse ngre padi kundër presidentit aktual Hashim Thaçit, moralisht nuk ka vend për kandidatura serioze. Përqendrimi do të duhej të ishte në përgatitjen e institucioneve që ta përballojnë, brenda kuadrit kushtetues, goditjen nga Gjykata Speciale, nëse ajo goditje ndodhë vërtet. Kuvendi dhe qeveria do të duhej të koncentroheshin në maksimum për ta përballuar sfidën, por edhe opozita do të duhej të ishte maksimalisht konstruktive. Nëse Kushtetuta e parasheh që kryetarin e zëvendëson kryetari i Kuvendit, nuk ka pse të ketë nguti, pasi nuk paraqitet vakum institucional brenda gjashtë muajve. Pra, nuk duhet të paragjykohet personi, në këtë rast kryetarja e Kuvendit, e cila në rast nevoje mund ta marrë funksionin e presidentit. Por, në mentalitetin provincial që dominion në skenën tonë politike, paragjykimi është i pashmangshëm. Siç duket, kjo është arsyeja e gjithë ngutisë, që të zihet pozicionet startuese, në mënyrë që të shmanget "befasia", e cila në këtë rast nuk do të ishte kurrfarë befasie, por vetëm zbatim i germës së Kushtetutës. Natyrisht, me paragjykimin vjen edhe manipulimi, për të cilin në antikulturën tonë politike ka një traditë të lashtë bizantino-sllave. Manipulimi tashmë është ravijëzuar në formë presionesh e kalkulimesh brenda koalicionit qeveritar, po edhe të aktorëve të tjerë. Por, më duket se në fund të procesit, qoftë ai rotacion normal ose i imponuar nga vendimi i Gjykatës Speciale, shumë njerëz do të mbeten me gishta në gojë. Siç mbeti me gishta në gojë "kryeministri shqiptar" në Maqedoni të Veriut, ku pas dështimit, u manipulua se gjoja vetë Zoran Zaevi na qenkësh shqiptar, siç i paskësh thënë Ali Ahmetit një sharlatan që tallet me historinë. Pra, me zgjedhjen e Zaevit, na dilka që BDI-ja e ka mbajtur premtimin për një "kryeministër shqiptar në Maqedoni", pasi Zaevi na qenkësh shqiptar! Kjo është fyerje e inteligjencës së njeriut normal. Por, faktikisht, ky është degradimi ku kanë rënë elitat tona politike, si në Kosovë, si në Maqedoni, si në Shqipëri, të cilat gënjejnë ditën për diell, pa iu dridh qerpiku. Gara e palavdishme për karrigen e presidentit të Kosovës është brenda kësaj skeme. Ama, edhe kanë gjetur popull të përshtatshëm për t'u tallë me të. Në fakt, vetë e kanë lënë në injorancë popullin dhe vetë e sundojnë, si u vjen më mbarë. Kështu do të jetë edhe me zgjedhjen e presidentit të Kosovës: një tallje e madhe me popullin dhe, në fund, një zgjedhje që imponohet jo nga interesi i popullit, por nga matematikat e partive dhe nga diktati i të huajve. Ndërkaq po shihet se populli nuk i kupton matematikat e tilla ose shtiret se nuk i kupton, pasi është në pamundësi që vetë t'i llogaritë interesat e veta. Karrigia e presidentit është e zënë edhe kur formalisht është bosh, ngase në çdo variant në të e vendosin dikë që nuk e ka miratimin e popullit. Siç duket, pikërisht ajo mungesë përgjegjësie para popullit e bën atë pozitë edhe më atraktive. Por, me këto mendësi e me këto veprime, siç thotë një fjalë e urtë, (ky shtet) "nuk ka pshtim, ka veç vanim". Me një president që nuk përfaqëson as popullin, as shtetin, po vetëm mujsharinë partiake ose vetëm të kaluarën, epilogu i tillë vetëm sa përshpejtohet.

# Thikat



Arben DEDJA

## Thikat

Kur në qershor të vitit 1995 vajtëm për disa ditë në Ohër të Maqedonisë, në një konferencë mbi gruan që zhvillohej në një nga hotelet buzë liqenit dhe teksa gratë merreshin me atë konferencën e tyre e ne bënim banjë në gjolin e mrekullueshëm (çka për vite e vite e kishim bërë në anën shqiptare të liqenit), takuam, në ato orë relaksimi midis kredhjeve në ujë, leximeve dhe bisedave me fëmijët shqiptarë të fshatrave rrotull, zonjën e vjetër dhe të çuditshme serbe Jovanka S., që bënte edhe ajo banjë dielli dhe, e quajmë të çuditshme sepse, besojmë, është e vetmja serbe shqiptarofile që kemi njohur apo dëgjuar gjer më sot. Ne biseduam gjerë e gjatë, përveç (pashmangësisht) mbi raportet midis serbëve e shqiptarëve treguam edhe diçka nga jeta personale e gjithsecilit, kështu që edhe ajo na tregoi diçka nga e vetja, që na bindi përfundimisht që kishim të bënim me një personazh *të çuditshëm* dhe, bile, na u duk sikur e zbuluam se ku qëndronte ai element, të themi, krisjeje, çakërdie në jetën e zonjës e cila, sigurisht, më shumë se cilido që e njohim mirë, do ta meritonte kryetarllëkun e një tjetër shoqate të pritshme miqësie Serbi - Shqipëri. S'na kujtohen detajet, por me çiltërsi zonja rrëfeu që, kur para disa dhjetëra vitesh kishte pasë qenë lidhur me një burrë, një fakir nga stepat siberiane, nga ata që në gjendje transi shpohen me shtiza apo hanë shpata, një ditë të bukur, për t'i ngjarë, për ta impresionuar apo thjesht për t'i shprehur dashurinë, rrezikoi jetën teksa gëlltiti 10 thika nga servisi më i mirë i shtëpisë, të cilat pastaj, ndryshe nga ç'kujtonte, s'arrinte dot t'i nxirrte prapë, çka e detyroi, kësisoj, t'i nënshtrohej një ndërhyrjeje kirurgjike të gjatë dhe delikate.

## Autobiografi

Një ditë, në një mot të butë shtatori të vitit 1967, një djalë, rreth 3 vjeç e gjysmë, me flokë të zeza dhe balluke të prera shtrembër, pak më shtatgjatë se mesatarja e moshës, i veshur me një përparëse të bardhë që në ditët në vazhdim do të ndotej gjithnjë e më shpesh, u paraqit me prindër përdore te porta e kopshtit nr. 16 të kryeqytetit. Megjithëse i kishte gjallë dhe me shëndet të plotë dy gjyshet, një gjysh dhe një stërgjyshe (me banim në një rreze jo më larg se 100 metra nga apartamenti i djalit) prindërit kishin vendosur ta fusnin në kopsht që "të rrihej" me jetën. Ishte nga ata fëmijë për të cilët thuhej që "nuk lë dy gurë bashkë" dhe, ndoshta, pikërisht në sajë këtyre gurëve që nuk i linte bashkë kish në ballë një çikatricë bërë nga një gur i mprehtë me të cilin e patën qëlluar (burrë, ajo krijoi një rrudhë që u përhumb në vizatimin e fytyrës) dhe një tjetër në çaçkë të kohës, krejtësisht e fshehur nga flokët (burrë, ndryshe nga çikatrica e parë, ajo do të dilte më fort në pah). Vinte i ndrojtur, ishte nervoz dhe mërzitej shpejt. Quhej Arben Dedja dhe nuk e dinte akoma që do të bëhej shkrimtar, edhe pse, ndoshta, nuk e meritonte.

## Shqiponja

Vetëm kur edhe foshnja e tretë u zhduk nga djepi i vet në fshatin malor të Th., dyshimet erdhën e u përqendruan te një shqiponjë që kish kohë që fluturonte atypari. Dy të rinj të fshatit bile u kuturisën drejt faqes së malit përballë, ku mendohej se shpendi kishte folenë, me shpresë mos gjenin aty ndonjë pampers apo cullufe që t'ua vinte kapakun dyshimeve, por shkëmbi qe aq thikë dhe rrebeshi i pranverës së vonë që i zuri papritmas aq i rreptë sa u druajt gjatë për jetën e tyre. Ishte ky çasti kur nuset e fshatit rrëmbyen armët dhe filluan të qarkullojnë të armatosura (hedhur supit pushkën e shpinës djepin), por këto armë çvarur vjegash veç sa acaruan edhe më marrëdhëniet e tyre me gazetaret, që kishin marrë të tatëpjetën kur, pas zhdukjes më të fundit foshnjore, njëra sosh, me gjasë për t'i rritur jehonën lajmit, kish vënë në dukje si kjo thagmë pat ndodhur pikërisht më 1 qershor, Ditën e Fëmijëve. Atëherë edhe disa prej gazetareve, çuditërisht e veçanërisht ato që punonin për revista mode apo rozë, u armatosën nga ana e tyre dhe për do kohë të dyja palët qarkullonin ngjeshur gjer në dhëmbë, kur i thonë, ledheve të fshatit Th., por pa u fshikur, ama, aq sa duhet pohuar, për hir të së vërtetës, që zahiretë te Kulla e Ngujimit nuk u quajt e arsyeshme të shtohen atë vit, si për vit pas të korrave.

Ornitologë të huaj u morën në pyetje për këtë hop cilësor në marrëdhëniet e shqiponjës, zogut kombëtar të shqiptarëve, me banorët e trojeve alpine të Th., sepse kurrë, të paktën sipas gojëdhënave, nuk ishte vërejtur një agresivitet i tillë i shqiponjës së atyre bjeshkëve, që qe mjaftuar me qengja pirës rrëmbyer tek-tuk barinjve të hutuar dhe me ndonjë breshkë të bëshme që e hidhte pastaj nga lartësia për t'ia thyer zhguallin mbi shkëmb, apo mbi kokën tullace - marrë gabimisht për gur - të dikujt që meditonte atypari (si rasti i ish-kryetarit të kooperativës malore të zonës, Rrok Sh., që, në fakt, nuk ngjante edhe aq i besueshëm, sepse një e tillë ngjarje pat ndodhur mijëra vjet më parë në Siqeli). Gjithsesi, përgjigjet e specialistëve, ndonëse të vagullta, e patën efektin e tyre anestetizues, se vera po zvarritej anonime, ashtu e gjatë dhe e qetë dhe me siguri do të ish shuar si e tillë për të hyrë pastaj si hajdute dyerve të vjeshtës, sikur nusja shtatëmbëdhjetëvjeçare e fisit të Zogajve, në zagushinë e një pasditeje gushti, të mos kish qëlluar me breshëri drejt qiellit, duke bërë të mjaftonte veç jehona e plumbave që i madh e i vogël të zaptohej në fyt nga makthi që i shkaktonte çdo hije, qoftë dhe e pafajshme e ikanake, që mund të fërfëllonte befshëm mbi një djep. Foshnja as e kishte kuptuar rrezikun dhe gugaste nën kurorën e mollës si përpara edhe pas breshërisë, teksa e reja, në ngërç e zbehtësi, aty për aty nuk ishte në gjendje ta rrëfente ndodhinë dhe pat filluar të belbëzojë vetëm pasi i zbrazën mbi kokë një vedër ujë të pusit aty pranë.

Buja e këtij rasti i zgjoi më në fund autoritetet, që dërguan në Th. një dedektiv me përvojë (banorët e atyshëm s'di pse e thërrisnin "kapucar"). Quhej Moll Gjika dhe vinte rrondokop. Ky vërtet që i vuri gjoksin punës dhe, pas një hetimi të shpejtë, arsyetoi me aq elegancë mbi çështjen, sa habitemi për turbullirën që solli e gjithë kjo në opinionin publik. E para gjë që bëri komisar Molli ishte marrja në pyetje një për një e me detaje e të gjitha grave me lehoní gjatë periudhës në fjalë, pavarësisht a kishin qenë sulmuar nga shpendi. Ja fragmenti kyç i raportit të tij përfundimtar:

"[...] Mund ta pohojmë me bindje që autore e këtyre rrëmbimeve është shqiponja (*Aquila chrysaetos*), autoktone prej shekujsh në trojet tona. Përpos kësaj, u përpoqa ta gjej arsyen e thellë që e shtynte zogun krenar ta linte folenë majë bjeshkësh të pakalueshme, për të mbërritur deri te kullat e fshatit Th. Isha i sigurt që shpendi ynë në këtë fluturim theqafës e në pikiatë tërhiqej nga një dëshirë e thellë, nga një gjakim. Rastet fatkeqe (plus i mbeturi në tentativë) i krahasova me të tjera, në të njëjtën kohë e vend, por ku asgjë nuk kish ndodhur. Është zakon i vjetër, buruar nga bonsensi, që lehonat, kur kanë për ta punuar bahçen, për të mbushur ujë, apo thjesht kur kapërcejnë pragun e kullës për mijëra andralla të tjera shtëpiake, t'i marrin foshjat me vete duke i rehatuar me kujdes nën hijen e ndonjë peme. Kështu i mëndin kur duhet dhe mund t'ua dëgjojnë të qarën [po qe se foshnjat mbesin brenda mureve të trasha me gurë të palatuar të kullave, e qara (siç e provova edhe vetë në simulimin që kreva me një lehonë që pati mirësinë t'i nënshtrohej eksperimentit) nuk ka gjasa të kapet]. Në stinën e bukur të vitit, dielli u bën fort mirë të porsalindurve, para se lëpetë e vjeshtës t'i detyrojnë prindërit t'i mbyllin brenda, pararendje për dimrin e gjatë.

Pas marrjeve të hollësishme në pyetje ia dola ta qëmtoj dallimin thelbësor midis lehonave që u ishte rrëmbyer foshnja dhe atyre që kjo nuk u kish ndodhur. E pra, dallimi ishte vetëm një: flamuri. Foshnjat e sulmuara qenë vënë të preheshin nën një pemë (zakonisht pema më e vjetër dhe e dendur e kopshtit) që kish në majë flamurin tonë me shqipen e zezë dykrenare, ndërkohë që ky flamur mungonte përmbi foshnjat e tjera. Tash supozimi im është që shqiponja zbriste aty e tërhequr seksualisht nga shqiponja e flamurit, me dëshirën e ndrydhur për t'u çiftëzuar me të dhe sulmi ndaj foshnjave vinte vetëm si efekt anësor i këtij akti, mbasi çiftëzimi ish kurorëzuar, ose si pasojë e mohimit të tij. Siç pohojnë ornitologët, shqiponja është shpend i besës: mashkulli dhe femra lidhen njëherë e përgjithmonë dhe i qëndrojnë besnik gjer në vdekje njëri-tjetrit. Supozimi im, pra, është që shqiponja në fjalë është e dashuruar marrëzisht me shqiponjën e flamurit dhe e ndjek atë pa prâ nëpër fshat, duke e parë të replikuar nëpër flamurët e kullave. Gjëja që nuk arrij dot të përcaktoj është gjinia e shqiponjës *vrastare* (më lejoni ta përdor këtë term, që nuk kërkon të jetë aspak fyes). Folenë e ka ngritur mbi shkepa të paarritshëm dhe, përpos kësaj, ky lloj është i mbrojtur me ligj. Por në qoftë se supozimi im është i drejtë, për ta përcaktuar gjininë e kësaj shqiponje mjaft të përcaktojmë gjininë e shqiponjës së flamurit. Kjo të mos iu duket e thjeshtë se, megjithëse i ktheva parë e prapë të gjithë flamujt e fshatit me ndihmën e një heraldisti, prapë nuk munda t'ia përcaktoj dot gjininë shqipes së flamurit. Mendoj dhe jam i bindur që, megjithëse fakte të tjera hëpërhë mungojnë, ky çiftëzim i shqiponjave të bjeshkëve tona me shqiponjat e flamurit është një dukuri mbarëkombëtare e përtejkohore që e ka shoqëruar shqiptarin, zot të trevave të veta, nëpër shekuj".

Kaq raporti. Duhet thënë që kur shtypi shqiptar bëri të ditur botërisht këto përfundime, opinioni publik ndërkombëtar u tregua i vakët, skeptik, teksa opinioni i brendshëm i përqafoi me interes dhe u ndie i mikluar, do të thoshim krenar, që shqiponja e bjeshkëve tona dhe ajo e flamurit hykëshin në një të tillë kontakt intim. Dikush nga të paktët veteranë të luftës mbetur gjallë tregoi, i intervistuar *ad hoc*, që e kish ditur prej kohësh këtë, duke sjellë ndër mend ngjarje të vjetra kinse të ndodhura që gjatë çlirimit të vendit, që askush nuk ishte në gjendje t'i konfirmonte, pos ndonjë sivëllai të vet të currufjepsur. Ishte kur Partia Kombëtariste Shqiptare po përpiqej, nën valën e entuziazmit shkabor, të fitonte ndonjë bashki në zgjedhjet e atëbotshme vendore, që opinioni publik mbi këtë çështje u copëzua në rryma, nënrryma e grupe me kundërshtí pikëpamjesh mes tyre. Ndërhyrja e një eksperti gjenetist u bë shkaku. Ai e la mënjanë debatin paralel që raporti i Moll Gjikës ndezi me pamundësinë (do të thosha teknike) e përcaktimit të seksit të shqiponjës së flamurit dhe, si pasojë, edhe të shqiponjës në fjalë (u përjashtua *a priori* mundësia që shqiponjat të ishin *gay*) dhe u përpoq të bënte një analizë sa më shkencore, për të kuptuar se cilët mund të ishin pasardhësit e një bashkimi të tillë seksual (i mëshoi, pra, faktit që në natyrë çiftëzimi ndodh për arsye riprodhimi dhe jo si te njeriu, për sport). Problemi kryesor që shtrohej ishte ai i numrit të kokave të pasardhësve dhe për t'u përballur me këtë çështje, gjenetisti po përpiqej të arsyetonte nëse dykrenësia e shqiponjës së flamurit duhej cilësuar si një tipar në homozigozë, apo heterozigozë. Vetë ishte për të dytën kur folësit e tjerë në debat, të ashtuquajtur ekspertë, me zanate nga më laryshanet (folklorist, shtangist, ndonjë kirurg, mjek vërtet, por me njohuri efemere nga lënda e gjenetikës) ndërhynë për ta theksuar bindjen e tyre të pakundërshtueshme se dykrenësia e shqipes së flamurit të shqiptarëve nuk mund të ishte veçse tipar në homozigozë.

"Jo vetëm dykrenësia e shqipes është një tipar në homozigozë, - ndërhyri prerazi kirurgu, - por është edhe dominues".

Në këtë pikë gjenetisti shpjegoi me qetësi që, nëse do ta merrnim të mirëqenë këtë fakt, plus faktin, tashmë të përqafuar katërçipërisht nga opinioni publik, që çiftëzimi i shqiponjës së flamurit me shqiponjat e bjeshkëve tona ishte një akt që riprodhohej prej shekujsh, homozigoza dominuese do të

çonte pashmangshëm në pasardhës të këtij çiftëzimi vetëm shqiponja dykrerëshe çka, me kalimin e kohës, do t'i bënte të gjitha shqiponjat e bjeshkëve me dy kokë. Për atë diell, nëse kjo ishte e vërtetë! Mundësitë ishin dy: ose shqiponjat që çiftëzoheshin me shqiponjën e flamurit ishin "të huaja", ardhur, pra, nga përtej kufirit, serbe me pak fjalë, që, pavarësisht nga kokat që u dominuakëshin, po themi, nga shqipja e flamurit, sillnin sigurisht me vete një bagazh gjenetik të tyrin që transmetohej te pasardhësit, shìgur duke ua trazuar këtyre shqiponjave autenticitetin (pëshpëritje në sallë; zhurmë, kërkëllimë hekurash nën stolin ku qe ulur shtangisti), ose, siç e donte një logjikë e shëndoshë: tipari i dykrenësisë ishte dominues vërtet, por në heterozigozë. (Në këtë pikë bashkëbiseduesit filluan të përcillen dhe ta kafshojnë gjuhën). Gjithsesi, tre skenarë hapeshin, sepse aq ishin tipat e dominancës në heterozigozë. Në rastin e parë dominanca e thjeshtë, mendeliane, do të sillte: 25% e zogjve = me dy koka (homozigozë), 50 % e zogjve = me dy koka (heterozigozë) dhe 25 % e zogjve = me një kokë (homozigozë). I binte që në ¾ e rasteve shqiponjat e lindura nga ky bashkim të kishin dy koka, një përqindje kjo mjaft e lartë, në kontrast me ç'ishte shkruar rreth florës e faunës shqiptare në shekuj dhe me raportet e kopshteve zoologjike. Skenari tjetër ishte ai i bashkëdominancës (shih grupet e gjakut te njeriu), por për këtë gjenetisti u shpreh mjaft skeptik, përndryshe duhej të vërtetonim praninë (në natyrë, në heraldikë), ndonëse në masë të vogël, edhe të shqiponjave me tri koka (dy plus një, "dy koka e një kuzhinë", siç tha nëpër dhëmbë shtangisti), gjë e paparë dhe e padëgjuar. Edhe tipi i tretë i dominancës, dominanca e paplotë, bëhej problematik në shpjegim, sepse jepte zogj me një kokë e gjysmë, pra të papajtueshëm me jetën. Sipas gjenetistit, kjo ishte ajo që ndodhte nga çiftëzimi i shqiponjës së bjeshkëve me atë të flamurit: lindja e zogjve të dështuar, që nuk mund të jetonin dot dhe ishte ky momenti kur folkloristi ynë u ngrit nga stoli i tij dhe me një varé të zezë, të stërmadhe, filloi të shkatërronte studion televizive ku po zhvillohej debati.

I vetmi që doli i larë nga kjo ngjarje tragjikomike ishte dedektiv Molli që, në fakt, u vlerësua nga të gjithë, edhe nga ata që nuk ia pëlqyen konkluzionet, duke bërë kështu që të përfshihet në të tjera hetime interesante për të cilat, ndoshta, do të kemi rast t'ia dëgjojmë zulmën.

*(Marrë nga revista "Akademia", nr. 7)*

# Nëna ime

## *(fragment nga romani Una)*



FARUK ŠEHI

Nëna ime e donte Titon, edhe pse ajo ishte myslimane sipas rregullave të shërbimit, sepse i falte pesë namazet ditore. Burri i nënës sime e ka lënë atë me tre fëmijë, të cilët ajo i lindi në tunelet hekurudhore, aty ku njerëzit strehoheshin nga aviobombat e aleatëve. Ishte fundi i Luftës së Dytë Botërore dhe nëna ime mbeti vetëm, sepse burri i saj shkoi pas fundit të njëfarë Jagodës në Banja Llukë, kështu thotë tradita gojore e familjes.

Ajo nuk ka mundur ta urrente socializmin ani pse partizanët ia kishin pushkatuar dy kushërinj të afërm me akuza të dyshimta se ata ishin bashkëpunëtorë të armikut. Të gjithë familjarët e nënës ishin për partizanët. Edhe vetë nëna, atëherë nëpunëse gjyqësore, bashkëpunonte me lëvizjen e rezistencës. I barte porositë në një çantë prej lëkure ngjyrë bezhë. Bashkëpunimi i saj me komunistët mbeti një mister i thellë. Për këtë arsye, pas përfundimit të luftës nuk kishte kurrfarë përfitimi material nga ajo vaki. Pas shumë vitesh sall këpucët ngjyrë kremi, ato me majë të topitur, ia përkujtonin kohën kur me mini fund me çantë në dorë barte porosi prej njërës celulë të PK te tjetra. Dhe kjo ndodhte kur ngjitej shkallëve të drunjta e të rrëpirëta në mansardë, ku i ruante këpucët e vjetra, për t'i futur teshat në rrobalarëse, ose për të shkuar në dhomën e Shetinës prej nga, e mbështetur në bërryla, mund të shikonte me orë të tëra Unaxhikun dhe mund të shihte edhe më tutje mbi shelgje, nëpër një rrugicë me plepa anash, deri në fund të nisisë, aty ku Una kthehet në një shtrat dhe më tej ajo vazhdon vetë, drejt Jasenovcit. Bash atje ku ai burri që e kishte lënë i kaloi dy vjet në kamp përqendrimi.

Nëna nuk dorëzohej derisa burri i saj ishte në kampin e përqendrimit në Jasenovc. Përkundrazi, ajo shkonte me tren në Zagreb, me hekurudhën e Unës, e cila deri në Kostajnicë besnikërisht ndjek lumin dhe përpiqej ta nxirrte burrin e saj nga kampi i vdekjes. Nëpërmjet disa myslimanëve të rangut të lartë në qeverinë e NDH (SHPK) nëna ia doli ta nxjerrë të shoqin nga kampi i vdekjes pasi që ai kishte kaluar aty dy vjet. Tradita gojore e familjes thotë se më parë ai kishte qenë nja gjysmë viti në Stara Gradishkë, për të cilën janë kënduar edhe këto vargje: "Jasenovci dhe Gradishka Stara janë shtëpitë e kasapëve të Maksit".

I shoqi i nënës i mbijetoi kasapët e Maks Luburiqit dhe të gjithë kasapët e Jasenovcit. Lidhja misterioze e nënës e transferoi të shoqin e saj te *domobranët*, dhe aty u bë kapiten, pasi që kishte mbaruar studimet universitare. Nga *domobranët* i shoqi i nënës sime iku dhe iu bashkua partizanëve. Dihej se nëna ndoshta kishte edhe fuqi mistike, ashtu që fuqia e saj e brendshme prodhonte sugjestion të fortë në bashkëbiseduesit e saj, të cilët, pa menduar fare dhe mirë, kryenin sugjerimet e saj. Njashtu e shpjegonim aktin e saj të lirimit të gjyshit nga kampi i Jasenovcit.

Nëna ime, si çdo çudibërës i vërtetë, kurrë nuk fliste për fuqitë që i zotëronte. Thoshte se realiteti është një lodër në duart e Zotit, dhe se njerëzve u ndihmonte Allahu, Perëndia që kjo i lutej në pesë namazet ditore për çdo njëzet e katër orë që nga mosha tetëmbëdhjetëvjeçare. "Njeriu ëndërron, zoti përcakton" - na thoshte nëna.

Unë jam tash shumë i vogël, aq i vogël saqë Mirdal Terziq më bart në një kaçle, të cilës ende i vjen era e bukës taze dhe e qumështit rrugës së Pazarxhikut deri te shtëpia e nënës. Para se të mbërrijmë te shtëpia e nënës ndalesa e parë e ndërmjetme është në Zhitarnicë, aty do të luajmë badminton. Mirdal do ta luajë badminton me moshatarët e tij, ndërsa unë më kot do ta ndjek një grerëz të trashë duke u përpjekur për ta zënë me raketë dhe për ta lansuar në univers.

Në kodër mbi Zhitarnicë punëtorët zhgozhdojnë shtëpinë e vjetër dhe i hedhin trarët nga çatia nëpër pemë që kanë dalë buzë shkëmbi. Trarët thyejnë degët dhe me zhurmë të madhe bien prapa një vargu të garazheve të llamarinta, në afërsi të një trafostacioni dhe WC publike që tashmë e kishte mbuluar bimësia. Mirdali më thotë që të shkoj dhe ta kap trarin në fluturim. Unë vrapoj drejt njërës që binte ngadalë dhe ndiej duart e Mirdalit se si më kapin para se të arrija ta kryeja misionin vetëvrasës. Atëherë, për të më ndëshkuar më futën në kaçile nga e cila më shihet sall kryet, e cila tundet në harmoni me hapat e Mirdalit dhe po shkojmë në drejtim të Ustikolinës. Nga Ustokolina shihen nisitë, stadiumet e futbollit dhe Ajaku ku do të lahemi tinëz në fillim të pranverës. Atje ku një herë do të notoj në gjelbërimin e patejdukshëm të lumit, gri nga shiu i natës dhe aty ku Senadi do të më shpëtojë nga mbytja. Ishte muaji prill, kishte shumë ujë dhe uji ishte i akullt. Atëherë peshku kapej në grep pas krimbave. Kur mbijetova mbytjen vdekshmëria u fut në mua si një plak në banesën të sapobojatisur me pamje nga deti. Shoku im i fëmijërisë, Seadi, e ka mbijetuar luftën, por vdiq në një aksident si shumë luftëtarë të tjerë të kalitur, të cilët vdiqën në vitet e para pas luftës.

E pashë tymin që dilte nga shtëpia e nënës dhe u lëshuam teposhtë shkallëve të ngushta pranë shtëpisë së Harbashëve, ku në një mur me myshk më pëlqente t'i studioja kërmijtë jargorë bojë portokalli, herët në mëngjes, pasi që veç e përmenda, para se bota e të rriturve t'i merrte konturet e saj serioze.

Kur ndërtesat harmonizohen në kënde të drejta, çatitë zbresin nëpër shtëpi, dritaret kthehen nga udhëtimet kozmike, plot acar sepse ato kanë qëndruar në lartësitë më të mëdha se dhjetë mijë metra. Bota krijohet nga fillimi për çdo mëngjes. Shelgjet, vërret, shtogjet dhe plepat mugullojnë sërish në brigjet e Unazhikut. Toçilla dhe kodrat e tjera, në kufirin e hollë ndërmjet natës dhe ditës, ngrihen nga toka duke zënë karriget e tyre të qëndrueshme gjeografike. Natën sall krevati nuk është iluzion dhe, në qoftë se ndokush do të mund të qëndronte zgjuar dhe në të njëjtën kohë të flinte, do të mund të shihte krevate të panumërta njerëzore se si lundrojnë ngadalë drejt mëngjesit.

Unë dal nga kaçilja dhe vrapoj drejt bregut ranor para shtëpisë së nënës. Poshtë shikoj peshqit: losët dhe troftat. Bregut të lumit i vjen era e bimëve barishtore, kallamishteve dhe tubacioneve të kanalizimit që shihen në brigjet e gjelbra dhe të gjitha këto i thith me krejt mushkëritë e mia. Peshqit lëvizin, herë me nervozë herë të frikësuar, pastaj qetësohen dhe rrinë gjatë në një vend sikur të bënin roje. Kjo është bota ime. Aty jam peshku që iu është përshtatur jetës në tokë. Jam dëshmi e gjallë e evolucionit darvinian. Unë jam hallka që nuk mungon, fazë tranzicioni prej peshkut te njeriu, ani pse në mënyrë të përkryer dukem njerëzor. Çfarë pasioni i çuditshëm është ky për të cilin do të vdisja urie sall për të mundur t'i shikoja peshqit, bile edhe në muzg, kur çdo gjë errësohet, e peshqit si shtiza të zeza notojnë gjithkah duke e parandier natën, kohën kur çdo gjë trazohet, hëm kafshët, hëm njerëzit.

